

KËRKESË
Nr.3371/3, datë 30.5.2008

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të shkollës së mesme dhe konviktit, në qytetin e Peshkopisë.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është bashkia Peshkopi.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË
SHKOLLËS SË MESME DHE KONVIKTIT NË PESHKOPI**

PRONARI	Z.K.	NR.PAS.	SIP.TRUALL	ÇMIMI TRUALL LEKË/M ²	VLERA E TOKËS (LEKË)	VLERË TOTALE E SHPRONËSIMIT (LEKË)
ASLLAN HALIT HOXHA (KUÇKA)	2932	10/27, 10/29	6000	20.675	124 050 000	124 050 000

Vlera totale e shpronësimit është 124 050 000 (njëqind e njëzet e katër milionë e pesëdhjetë mijë) lekë.